



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Vitisë  
Opština Vitina – Municipality of Viti  
DREJTORIA PËR KULTURË RINI DHE SPORT  
Sektori për Rini dhe Sport

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Data - Prilloga Më/Dana		30-12-2019	
Nr. i organit org. broj	Numri/Sroj	Shtoi Prilo	Vite Prerodba
	01-013/1963		

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 lidhur me nenin 12. Paragrafi 1 pika c. Të ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr .03/L-040 në kordinim me nenin 11. Paragrafi 2 pika p. Të statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/191 i datës 21.04.2011. Kuvendi i Komunës miraton këtë :

## RR E G U L L O R E

### PËR PROCEDURAT E THEMELIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR TË KOMUNËS SË VITISË

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Qëllimi

##### Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e themelimit, përfaqësimit, detyrat, përgjegjësitë, funksionimi, burimet financiare dhe mbështetja financiare, procedurat e ankesave dhe të shpërbërjes së Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL- së) në komunën e Vitisë.

##### Përkufizimet

##### Neni 2.

Në këtë rregullore, termat në vijim kanë këtë kuptim:

„Udhëzimi administrativ“ – nënkupton Udhëzimin administrativ nr. 9/2010, për përgjegjësinë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor të Kosovës.

„Drejtori“ - nënkupton organin e administratës së Komunës përgjegjëse për rini;

„Zyrtar rinor“ - nënkupton zyrtarin përgjegjës për rini në Komunë;

„KVRL“ - nënkupton Këshillin e Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Vitisë.

“Kuvendi i KVRL – së” - nënkupton Kuvendin, përfaqësues të organizatave rinore anëtare të KVRL – së.

“Bordi ekzekutiv” - nënkupton kryetarin, nënkryetarin, sekretari dhe 2 anëtarët.

#### II. DISPOZITAT E VEÇANTA

##### Themelimi i KVRL-së

## II. DISPOZITAT E VEÇANTA

### Themelimi i KVRL-së

#### Neni 3.

1. Zyrtari rinor fton organizatat dhe grupet tjera rinore të komunës për krijimin e këshillit iniciues për themelim të KVRL – së.
2. Këshilli iniciues përgatit mbajtjen e kuvendit për themelimin e KVRL - se.
3. Kuvendi nga përfaqësuesit e organizatave anëtare, zgjedh Bordin ekzekutiv, të përberë nga kryetari, nënkryetari, sekretari dhe anëtarët.
4. Kuvendi autorizon Bordin ekzekutiv për hartimin e Statutit dhe të Rregullores së punës të KVRL – së.
5. Pas miratimit të Statutit dhe Rregullores së punës në Kuvend, Bordi ekzekutiv bën kërkesë për regjistrim, sipas ligjit në fuqi, për organizata jo fitimprurëse.
6. Pas regjistrimit, në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Udhëzimit administrativ, KVRL bënë kërkesë me shkrim për njohje në drejtorinë përkatëse të Komunës për rini.

### Përfaqësimi

#### Neni 4.

Përfaqësimi i organizatave dhe grupeve rinore në KVRL, bëhet sipas nenit 11 të Udhëzimit administrativ nr. 9/2010, për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë.

### Detyrat

#### Neni 5.

Përveç detyrave të parapara sipas dispozitave të nenit 10 të Udhëzimit administrativ, KVRL ka edhe këto detyra:

- a. të njoftojë zyrtarin e rinisë për takimet e rregullta;
- b. të mbështesë organizatat anëtare për përgatitje të projekteve dhe aplikim për fonde;
- c. të informojë zyrtarin për rini lidhur me projektet e ndryshme të organizatave anëtare.

### Përgjegjësitë

#### Neni 6.

Përveç përgjegjësiave të parapara me dispozitat e nenit 10 të Udhëzimit administrativ, KVRL ka edhe këto përgjegjësi:

- a. të bashkëpunimit me këshillat rinorë në nivel lokal dhe Këshillin rinor në nivel qendror dhe ndërkombëtar, lidhur me çështjet që prekin këshillat rinorë;
- b. organizimi i seminareve, debateve, punëtorive, fushatave vetëdijesuese për çështje rinore në nivel lokal;
- c. promovimi dhe zhvillimi i vullnetarizmit.

## **Funksionimi**

### **Neni 7.**

1. Funksionimi i KVRL – së bëhet përmes:
  - a. Kuvendit të KVRL – së dhe
  - b. Bordit drejtues.
2. Kuvendi i KVRL – së përbehet nga të gjitha organizatat dhe grupet rinore, të cilat janë paraparë me Statutin e KVRL – së.
3. Bordi ekzekutiv ka kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe anëtarët.
4. Kuvendi ka përgjegjësi për mbajtjen e së paku një takimi vjetor, ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet, programet e Këshillit për vitin paraprak, si dhe planin për mjetet, të ardhurat, shpenzimet dhe programin e Këshillit për vitin vijues.
5. Kuvendi i KVRL-së nuk i delegon detyrat sipas paragrafit 4 të këtij neni:
  - a. zgjedhjen e zyrtarëve në pozitat udhëheqëse të KVRL – së;
  - b. ndryshimet dhe plotësimet në aktin themelues, apo statutin e KVRL – së dhe
  - c. vendimet për bashkimin, ndarjen, apo shuarjen e KVRL – së.

## **Burimet financiare**

### **Neni 8.**

Mjetet financiare të KVRL - së janë:

- a. kontributet nga përfaqësimi i organizatave në KVRL;
- b. 15% (pesëmbëdhjetë përqind) nga kodi buxhetor i subvencioneve nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport;
- c. subvencionet nga niveli qendror dhe subvencionet nga autoritet ndërkombëtare;
- d. donacionet dhe subvencionet nga organizata tjera, individët ose sponsorët e ndryshëm.

## **Mbështetja financiare**

### **Neni 9.**

1. Drejtoria kompetente për punë rinore, në pajtim me buxhetin e miratuar të Komunës dhe Planin e Veprimit për Rini, mbulon 15% nga kodi buxhetor i subvencioneve nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
2. KVRL për përfitimin e mjeteve financiare 15%, përgatit dhe i procerdon Planin e Veprimit dhe Strategjin për aprovim në Drejtorin për Kulturë Rini dhe Sport/Sektorin e Rinisë
3. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport/Spektori i Rinisë pas aprovimit të Planit të Veprimit dhe Strategjisë së KVRL, nënshkruan marrëveshjen kontraktuale për implementim të dokumenteve në fjalë dhe transferim të mjeteve buxhetore.
4. Raportet financiare dhe narrative/përshkruese të aktiviteteve i dorzohen DKRS/Sektorit të Rinisë sipas marrëveshjes kontraktuale të nënshkruar nga dy palëve.
5. Në raste të mos përmbushjes, ndryshimit të aktiviteteve të planifikuara dhe ndryshimit të linjave buxhetore pa konsultime me zyrtarin e rinisë gjatë implementimit të Planit të Veprimit apo Projektit, zyrtari për rini i propozon drejtorisë për një vendim të posaçëm në ndërprerë mbështetjen financiare KVRL-së.

## Konflikti i interesit

### Neni 10.

1. KVRL aplikon për programe specifike, si:
  - a. ngritja e kapaciteteve të organizatave anëtare;
  - b. realizimi i fushatave informuese dhe vetëdijesuese;
  - c. përmirësimi i nivelit të pjesëmarrjes së rinisë në aktivitete;
  - d. shkëmbimi i përvojave në nivel lokal, qendror dhe ndërkombëtar.
2. Anëtarët e KVRL – së përmbahen nga pjesëmarrja në diskutim, si dhe nga marrja e vendimit apo çështjeve të cekura në pikën 1 të këtij neni, në të cilat ata kanë interes personal ose financiar.
3. Secili transaksion financiar ndërmjet KVRL – së dhe anëtareve, zyrtarëve ose anëtarëve të Bordit, për çështjen e cekur në paragrafin 1, domosdo duhet të bëhet në vlerën e tregut ose në kushte më të favorshme për KVRL – në.

## Procedura e ankesës

### Neni 11.

Ndaj Vendimit të Kryetarit të Komunës për refuzimin e njohjes së KVRL – së, mund të ushtrohet ankesë pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Departamentit të Rinisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit të procedurës administrative në fuqi.

## Shpërbërja e KVRL – së.

### Neni 12.

Shpërbërja e KVRL – së bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatat jo fitimprurëse.

## Zbatimi

### Neni 13.

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoria kompetente që merret me çështjet rinore.

## III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Hyrja ne fuqi

### Neni 14.

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës së Vitisë.

Me dt. 29.12.2014

Kryesuesi i Kuvendit

z. Naim Pira

